REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KUVENDI**
***Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike***

Nr. 2812 Prot. Tiranë, më 21 / 09 /2023

**Lënda**: Njoftim i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mbi zbatimin e nenit 16 të Rregullores së Kuvendit

**Drejtuar**: **Znj. Lindita NIKOLLA**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar znj. Kryetare,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në mbledhjen e datës 19.09.2023 diskutoi mbi situatën e paprecedentë të krijuar nga ana juaj lidhur me Kryesinë e Grupit tonë Parlamentar, përmes leximit të njoftimeve private që kanë shkaktuar konfuzion tek opinioni publik dhe që nuk kanë asnjë lidhje me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike. Edhe pse nga ana juaj u pranua në seancën e datës 14.09.2023 se Kryesia e Grupit zgjidhet nga vetë deputetët anëtarë të Grupit, ne deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deklarojmë sa më poshtë vijon:

Në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 16 të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet se kryetari dhe kryesia e grupit zgjidhet apo ndryshohet nga mbledhja e grupit parlamentar dhe kjo i njoftohet Kryetarit të Kuvendit, ju bëjmë me dije se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk ka bërë asnjë zgjedhje apo ndryshim të Kryetarit apo Kryesisë së Grupit Parlamentar. Njoftimet private të lexuara në mënyrë provokative nga ana juaj nuk kanë asnjë lidhje me Grupin tonë Parlamentar dhe janë vetëshpallje pa asnjë efekt mbi grupin. Gjithashtu, në mbështetje të pikës 4 të nenit 16 të Rregullores së Kuvendit, ku specifikohet se: "Grupet Parlamentare miratojnë rregulloret e brendshme të organizimit të tyre", ju bëjmë me dije se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk ka bërë asnjë ndryshim të rregullores së tij të brendshme, ku qartësisht përcaktohet mënyra e zgjedhjes së Kryetarit dhe Kryesisë së Grupit, përmes votimit në mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve të grupit.

**Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 16 të Rregullores së Kuvendit dhe Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike", ne deputetët anëtar të Grupit Parlamentar të PD ju konfirmojmë se Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është z. Gazment Bardhi.**

Duke besuar se leximi nga ana juaj i disa njoftimve private ishte thjesht një lapsus dhe provokim i pajustifikuar, kërkojmë zyrtariasht ti jepni fund lojës me provokimin e opozitës dhe Grupit më të madh të opozitës parlamentare, të hiqni dorë menjëherë nga ndërhyrja në punët e brendshme të grupit tonë dhe tentativa për të krijuar një konflikt artificial brenda opozitës, si dhe në cilësinë tuaj si Kryetare e Kuvendit të respektoni vullnetin e anëtarëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**

**Deputetët anëtarë të Grupit Parlamentar:**

1. AGRON GJEKMARKAJ Agron Gjekmarkaj
2. ARBI AGALLIU
3. ASLLAN DOGJANI Asllan Dogjani
4. BLEDION NALLBATI Bledion Nallbati
5. BUJAR LESKAJ Bujar Leskaj
6. DASHNOR SULA DASHNOR SULA
7. DHURATA ÇUPI Dhurata Çupi
8. EDI PALOKA EDI PALOKA
9. ENKELEJD ALIBEAJ
10. ERALDA BANO
11. ERVIN SALIANJI Ervin Salianji

12. FERDINAND XHAFERAJ

13. FLAMUR HOXHA

14. FLUTURA AÇKA

15. GAZMENT BARDHI

16. GRETA BARDELI

17. HELIDON BUSHATI

18. INA ZHUPA

19. ISUF ÇELAJ

20. JORIDA TABAKU

21. KASTRIOT PIROLI

22. KRESHNIK ÇOLLAKU

23. LEFTER GESHTENJA

24. LINDITA METALIAJ

25. LUDOVIK HASANAJ

26. LULZIM BASHA

27. ORJELA NEBIJAJ

28. ORJOLA PAMPURI

29. QANI XHAFA

30. RAMADAN LIKAJ

31. SAIMIR KORRESHI

32. SORINA KOTI

33. TOMORR ALIZOTI

34. XHELAL MZIU

35. ZHENI GJERGJI